



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/141
Datë: 07.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Fushën e Zonave Ekonomike.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**KONCEPT DOKUMENTI
NË FUSHËN E ZONAVE EKONOMIKE**

Mars, 2017

KONCEPT DOKUMENTI

NË FUSHËN E ZONAVE EKONOMIKE

Kapitulli 1. Hyrje

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, është mekanizëm institucional ekzekutiv për zbatimin e Ligjit për Zonat Ekonomike në Kosovë. “Zonë ekonomike” nënkupton një zonë gjeografike në kuadër të territorit shtetëror, që ka një status të veçantë ekonomik, e krijuar për qëllime të zhvillimit dhe promovimit të bizneseve.

Zonat ekonomike janë një komponentë e programit të hapësirave të punës dhe si koncept nënkupton ndërtimin e një infrastrukturë fizike, të kompletuar dhe të gatshme për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve. Zhvillimi i zonave ekonomike përbën një faktor të rëndësishëm për përmirësimin e ambientit afarist dhe ndër të tjera ka për qëllim:

- Krijimin e një ambienti fizik për bizneset vendore dhe ndërkombëtare;
- Tërheqjen e investime të reja (vendore dhe të huaja);
- Grumbullimin e bizneseve në vende të përshtatshme për të bërë biznes;
- Zgjerimin industrisë ekzistuese;
- Zhvillimin e lokaliteteve të caktuara.

Zhvillimi i zonave ekonomike është një ndër elementet kryesore të zhvillimit të sektorit privat, andaj edhe është me prioritet dhe ka lidhshmëri me dokumentet dhe planet strategjike të qeverisë, të cilët kanë për qëllim zhvillimin ekonomik, respektivisht atë të sektorit privat, si: Strategjia Kombëtare për Zhvillim, Strategjinë për Zhvillim të Sektorit Privat 2013-2017, Programi i Qeverisë 2015-2018, Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit, etj.

Përmes Ligjit nr. 04/159 për Zonat Ekonomike, janë krijuar kushte më të mira për zhvillim ekonomik, duke krijuar dhe ofruar hapësira të punës për biznese, objekte të përshtatshme fizike (vende apo ndërtesa me infrastrukturë të qëndrueshme) në një ambient të kontrolluar dhe menaxhuar mirë, në një lokacion të përshtatshëm, të cilat janë një ndër elementet më të rëndësishme për zhvillim të sektorit privat.

Ligji për Zonat Ekonomike ka për qëllim nxitjen dhe inkurajimin e investimeve në Kosovë, hapjen e vendeve të reja të punës dhe krijimin e të ardhurave, përqendrimin e bizneseve në një vend të caktuar dhe promovimin e tyre, zgjerimin e bashkëpunimit mes bizneseve, krijimin e kushteve për biznese që të kenë qasje më të lehtë në transport, furnizim me energji elektrike, ujë dhe shërbime tjera në mbështetje të biznesit, rritjen e konkurrencës në biznesin vendor dhe ndërkombëtar, përshtetimin e zhvillimit rajonal dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut kosovar me atë ndërkombëtar, shpejtimin e qarkullimit të mallrave dhe të kapitalit etj. Krijimi

i mjedisit tërheqës për investimet private është prioritet kryesor, duke qenë se Kosova ka nevojë për investime private, posaçërisht për ato nga jashtë.

Në vende të ndryshme, si në ato të rajonit dhe më gjerë, zonat ekonomike janë treguar si njëri nga mekanizmat më të efektshme për tërheqjen e investimeve, si ato vendore po ashtu të jashtme.

Zonat ekonomike (ZE) konceptohen dhe do të ndërtohen në kuadër të sipërfaqeve/hapësirave të përzgjedhura në mënyrë të studiuar. Brenda tyre do të ngrihen ndërtesa dhe pasuri të tjera të patundshme për veprimtari prodhuese dhe të shërbimeve. Brenda zonave ekonomike do të ushtrojnë aktivitetet e tyre bizneset kryesisht prodhuese, të cilat lejohen për t'u vendosur që të operojnë brenda ZE.

KAPITULLI 2. Përshkrimi dhe definimi i çështjes / problemit kryesor

Ligji nr. 04/159 për Zonat Ekonomike ka për qëllim që përmes zhvillimit të zonave ekonomike të mundësohen investimet e reja, aktivitetet industriale dhe prodhimi për eksport, të lehtësohen hyrjet e mallrave dhe kapitaleve, të aplikohet teknologjia e përparuar, të krijohen vende të reja pune dhe të përfitohet nga mundësitë e investimeve dhe financimeve të huaja dhe shkëmbimeve tregtare. Ky ligj rregullon themelimin, funksionimin, menaxhimin si dhe mbikëqyrjen e zonave ekonomike në Kosovë. Me këtë ligj përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e zhvilluesve, përdoruesve/operatorëve dhe të subjekteve të tjerë që ushtrojnë aktivitete në lidhje me zona ekonomike, llojin e veprimtarive që kryhen brenda zonave ekonomike, mënyrën e lëvizjes së mallrave nëpër to, dhe lehtësirat fiskale të parashikuara në kuadër të tyre.

Megjithatë, edhe pse ligji për Zona Ekonomike ka qenë në fuqi që nga viti 2013, procedurat ligjore për themelimin e zonave ekonomike mbetet jo qartë të definuar. Pakjartësitë dhe boshllëku i krijuar nga ky ligj, ka paraqitur nevojën e plotësim ndryshimit të këtij ligji në mënyrë që të largohen pengesat për zhvillim të Zonave Ekonomike. Ndër problemet kryesore të identifikuar në këtë ligj janë:

- Neni 5 – për konfuzionin e krijuar ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror në lidhje me të drejtat e krijimit të zonave ekonomike,
- Neni 6 – për mos definimin konkret të emërimit “zonë e lirë” ekonomike, pasi që të qenit në zonë të lirë ekonomike nuk paraqet asnjë bënifit përveç atyre që janë të paraqitura në kodin doganor dhe të akcizave.
- Neni 8 dhe 9 – duhet të sigurohet që plani kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike nuk duhet të bie ndesh me ligjin për zona ekonomike.
- Neni 16–Librat e kontabilitetit dhe raportimi, të fshihet, pasi që është rregulluar me legjislacion përkatës dhe nga institucionet përkatëse.
- Neni 18 – të parashihen afatet kohore për fillimin e aktivitetet në zonën ekonomike, që nga krijimi i zonës.
- Neni 20 Këshilli Kombëtar për zona ekonomike. Të fshihet
- Neni 21 Dispozitat ndëshkuese, tek paragrafi 1, pika 1.1

1. Personi juridik ose subjekti do t'i nënshtrohet një gjobë prej dymijë (2.000) euro deri dhjetëmijë (10.000) euro, nëse ai kryen një nga shkeljet në vijim:

- o 1.1. fillon veprimtarinë në zonën ekonomike para marrjes së miratimit të nevojshëm të autoriteteve përkatëse.

Pika 1.1 e paragrafit 1 të nenin 21 të fshihet.

Këto nene janë të elaboruara me gjerësisht në vijim të këtij koncept dokumenti, tek **“Ligjet dhe aktet nënligjore”**

Akteret e prekur

Zhvillimi i Zonave Ekonomike ka ndikim në një numër të konsideruar të aktorëve relevant duke përfshirë të gjithë komunitetin e biznesit, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ministritë e linjës, si dhe komunat të cilat kanë një rol të rëndësishëm në procesin e zbatimit të ligjit.

Përmasat dhe Kohëzgjatja e Problemit				
Akteret e prekur	2013	2014	2015	2016
Komuniteti i Biznesit, respektivisht NVM-të	x	x	x	x
MTI	x	x	x	x
Komunat përkatëse	x	x	x	x

Grupet që më së shumti preken nga zonat ekonomike, janë komuniteti i biznesit, kryesisht bizneset prodhuese, sepse zonat ju japin përparësi bizneseve prodhuese dhe investimeve të huaja, të cilat rezultojnë me rritjen e punësimit dhe me tërheqjen e investimeve e sidomos investimeve nga jashtë.

Për të i adresuar këto probleme kemi diskutuar edhe me institucionet tjera relevanti si me MBPZHR, MMPH, MF, Asociacionin e Komunave dhe me asociacionet e bizneseve. Që të tëra janë pajtuar së duhet bërë ndryshime në format e zhvillimit dhe të menaxhimit të zonave ekonomike. Të cilat ndryshime duhen filluar nga legjislacioni. Vlen të theksohet se me aktorët relevant janë bërë vetëm diskutime pa konkluzione dhe të pa konkretizuara. Po ashtu edhe vet ligji nuk ka lejuar që të veprohet ndryshe, andaj fillimisht duhet të bëhen ndryshimet legjislative.

Politikat aktuale

Zonat ekonomike në Kosovë, rregullohen me Ligjin për Zonat Ekonomike nr. 04/L-159, të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr.6. 12 mars 2013 Prishtinë, si dhe me aktet nënligjore: Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 01/2014, për përcaktimin e procedurës së paraqitjes së kërkesës për marrjen e pëlqimit, procedimit të saj dhe dhënien e pëlqimit, mënyrën dhe procedurat për konsultim publik, si dhe përmbajtjen e regjistrit të zonave ekonomike, Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 02/2014, për përmbajtjen e studimit të

fizibilitetit, Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 03/2014, për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste, si dhe Udhëzimin Administrativ (QRK) - nr. 03/2014, për përcaktimin e kushteve dhe lehtësirave për bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kuadër të zonave ekonomike. Po ashtu, edhe me Udhëzimin Administrativ (MTI) - nr. 17/2013, për mënyrën e themelimit dhe funksionimit të inkubatorëve të biznesit.

Bartës të kësaj çështje është Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, gjithnjë në bashkëpunim me komunat përkatëse në të cilat krijohen zonat ekonomike.

Përgjegjësi e Komunave është ofrimi i pronës në të cilët do të ndërtohet/zhvillohet zona ekonomike, si dhe kompletimi i dokumentacionit, derisa e Qeverisë, respektivisht e MTI-së është pajisja me pëlqim për krijimin e zonës ekonomike, si dhe investimi në ndërtimin e infrastrukturës dhe krijimi i kushteve për të bërë biznes.

Më anë të këtij koncept dokumenti ndikimet e pritura janë të natyrës pozitive, sepse krijohet një përmirësim i ambientit veprues për ndërmarrjet që veprojnë në zonat ekonomike. Stimulohen ndërmarrjet prodhuese, ngrihen kapacitete konkurruese të prodhuesve vendorë, përmes kësaj bëhet edhe përmirësimi i bilancit të pagesave të vendit, zvogëlimi të papunësisë, rritja e të hyrave buxhetore, dhe si përmbledhje e të gjitha këtyre ngritja të mirëqenies sociale. Karakteristikë tjetër e këtyre zonave është edhe ndarja e bizneseve, respektivisht fabrikave nga vendbanimet dhe tokat bujqësore që kanë efekt direkt në ruajtjen e ambientit në vendbanime në njërin anë dhe ruajtjen e tokave bujqësore.

Ligjet dhe aktet nënligjore

Aktualisht, Kosova e ka legjislacionin sa u përket zonave ekonomike. Duke e pasur parasysh situatën ekonomike, Kosova është njëra ndër vendet në zhvillim, që ka nevojë për krijimin e parakushteve që do të ndihmonte në krijimin e hapësirave të reja të punës për zhvillim ekonomik dhe si rrjedhojë ngritjen e standardit të jetesës. Zonat ekonomike në Kosovë veprojnë sipas Ligjit për Zonat Ekonomike 04/L-159. Nismat e para për krijimin e zonave ekonomike kanë filluar në vitin 2004/2005. Ndërsa ligji i parë i zonave ekonomike, Ligji nr. 03/L-129, u miratua në vitin 2009, si legjislacioni i parë mbi zonat ekonomike në Kosovë. Më pas ky ligj u rregullua edhe me akte nënligjore. Në vitin 2013, Ligji nr. 03/L-129, u zëvendësua me Ligjin e ri për zonat ekonomike, nr. 04/L-159, si dhe me udhëzimet administrative.

Udhëzimi Administrativ (MTI) nr. 01/2014, për përcaktimin e procedurës së paraqitjes së kërkesës për marrjen e pëlqimit, procedimit të saj dhe dhënien e pëlqimit, mënyrën dhe procedurat për konsultim publik, si dhe përmbajtja e regjistrit të zonave ekonomike.

Udhëzimi Administrativ (MTI) nr. 02/2014, për përmbajtjen e studimit të fizibilitetit të zonave ekonomike

Udhëzimi Administrativ (MTI) nr. 03/2014, për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste.

Udhëzimi Administrativ (QRK) - nr. 03/2014, për përcaktimin e kushteve dhe lehtësirave për bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kuadër të zonave ekonomike.

Udhëzim Administrativ (MTI) - nr. 17/2013, për mënyrën e themelimit dhe funksionimit të inkubatorëve të biznesit.

Kosova miratoi ligjin aktual të zonave ekonomike, përkatësisht Ligjin nr. 04/L-159, në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 6/12 mars 2013, Prishtinë.

Ligji për zonat ekonomike ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik të vendit, megjithatë ka nevojë për përmirësime të mëtutjeshme, më qëllimin të krijimit të kushteve edhe më të mira për biznese.

Gjatë implementimit të ligjit dhe akteve nënligjore, janë identifikuar një numër problemesh themelore, ndër problemet kryesore janë:

- Neni 5 i Ligjit për Zonat Ekonomike të ndryshohet dhe të i jepet kompetenca kryesore Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për shkak se krijon konfuzion ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror sa u përket kompetencave të themelimit të zonave ekonomike. Në këtë nen ndër të tjera jepen këto të drejta, andaj rekomandojnë që të riformulohet paragrafët në vijim të cilat janë në ligjin aktual:

1. Zonat ekonomike të nivelit qendror themelohen me vendim nga Qeveria e Kosovës në bazë të propozimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe në bashkëpunim me komunën ose komunat përkatëse brenda territorit të së cilës parashikohet të themelohet zona ekonomike.

2. Zonat ekonomike mund themelohen me vendim edhe nga komunat brenda territorit dhe në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj. Por pas kompletimit të procedurave paraprake të komunës dhe kompletimit e dokumentacionit, duhet të merret pëlqimin nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për themelim të zonës ekonomike.

- Në Nenin 6 i Ligjit për Zonat Ekonomike të qartësohet koncepti zonë e lirë në kuadër të këtij ligji, pra të ofrohen lehtësira ose të eliminohet si term. Ky nen në ligjin aktual parasheh:

1. Qeveria me vendim themelon zonat e lira në bazë të propozimit të Ministrisë dhe konsultimit me Doganat e Kosovës dhe komunën në territorin e së cilës parashikohet të themelohet zona e lirë.

2. Për themelimin dhe administrimin e zonës së lirë zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit të Doganor dhe të Akcizave të Republikës së Kosovës.

3. Zonat e lira që përfshijnë ose gjenden brenda territorit të një qyteti ose vendbanimi mund të mos rrethohen nëse Qeveria, pas konsultimit me Doganat e Kosovës, vlerëson se një gjë e tillë nuk e pengon administrimin e zonës së lirë si dhe zbatimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Republikës së Kosovës.

Pra siç shihet në këtë nen quhet zonë e lirë, e realisht ato veprojnë konform e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Republikës së Kosovës, ashtu siç veprojnë të gjitha bizneset në Kosovë. Andaj rekomandojmë që ky nen të riformulohet, ose të lirohen të gjitha bizneset që vendosen në zona të lira ekonomike për 10 vite nga të gjitha tatimet dhe taksat ose të largohet termi “zonë e lirë”

- Të nenin 8, plani kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike, të eliminohet, pasi që në bazë të këtij plani parashihet se sa zona mund të krijohen brenda 5 vjetëve të ardhshme, që në një mënyrë apo tjetër bie ndesh me cenimin e së drejtës së komunave për krijimin e zonës ekonomike, si dhe bije ndesh me legjislacionin në fuqi. Rekomandojmë që e drejta të ju jepet të gjitha komunave në mënyrë të barabartë.
 - Neni 9, paragrafi 1, duhet të riformulohet dhe të harmonizohet me nenin 8 të ligjit, pasi që edhe ky nenë ka kompetenca për planin kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike, andaj ashtu siç përcaktohet në nenin 8, duhet të riformulohet edhe në këtë nen.
 - Në nenin 10 të Ligjit për Zonat Ekonomike të specifikohet mënyra e menaxhimit të zonave ekonomike publike, veçanërisht atyre në nivel qendror, sepse institucionet publike qendrore nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm për menaxhim të zonave ekonomike, dhe propozojmë që menaxhimi dhe mirëmbajtja e zonave ekonomike publike të bëhet nëpërmjet ftesës publike, prokurimit publik apo partneriteti publiko privat.
 - Neni 16 i cili flet për librat e kontabilitetit dhe raportimet financiare, të fshihet, sepse është i rregulluar me ligje tjera dhe nuk ka nevojë të duplikohet.
 - Neni 18 Përfundimi i aktiviteteve në zona ekonomike, të ri plotësohet, pra të parashihen afatet edhe për fillimin e zonës ekonomike (p.sh. nëse bëhen dy vjet nga krijimi i zonës ekonomike dhe nuk kanë filluar punimet, atëherë automatikisht humb të drejtën e statusit të zonës ekonomike) dhe afatit maksimal që mund të krijohet zona ekonomike (më së shumti 99 vjet).
 - Neni 20, këshilli kombëtar për zona ekonomike, ky nen të fshihet ose të riformulohet.
 - Neni 21 Dispozitat ndëshkuese, tek paragrafi 1, pika 1.1
 1. Personi juridik ose subjekti do t'i nënshtrohet një gjobë prej dymijë (2.000) euro deri dhjetëmijë (10.000) euro, nëse ai kryen një nga shkeljet në vijim:
 - o 1.1. fillon veprimtarinë në zonën ekonomike para marrjes së miratimit të nevojshëm të autoriteteve përkatëse.
- Pika 1.1 e paragrafit 1 të nenin 21 të fshihet.

Mangësitë:

- Thjeshtësimi dhe qartësimi i llojeve të zonave ekonomike që mund të krijohen si dhe përcaktimi i procedurës së themelimit të zonave ekonomike.
- Lejimin e ndarjes së zonave ekonomike në bazë të veprimtarive specifike, ku brenda zonës ekonomike mund të vendosen vetëm biznese me veprimtari të njëjtë sektoriale.
- Eliminimi i procedurave burokratike si dhe sigurimi se dispozitat ligjore mund të jenë menjëherë të zbatueshme.
- Ofrimi i lehtësirave më qëllim që të jemi konkurrentë me vendet e rajonit dhe më gjerë.

Programi aktual

Nuk ekziston ndonjë program aktual përveç planeve vjetore të punës dhe kërkesave që mund të vijnë nga komunat për të krijuar zona ekonomike.

Shpenzimet aktuale

Shpenzimet aktuale janë shumë të vogla në këtë fushë. Sektori është i përbërë nga dy zyrtarë dhe një udhëheqës, të cilit rreth 80% të kohës merren me krijimin, zhvillimin dhe menaxhimin e zonave ekonomike.

Në tabelën në vijim është paraqitur buxheti i Agjencisë për investime dhe përkrahje të ndërmarrjeve (KIESA), pjesë e së cilës janë është edhe sektori i zonave ekonomike. Kategoria e “shpenzimeve kapitale” është e dedikuar vetëm për zhvillimin e zonave ekonomike, ndërsa linjat tjera buxhetore janë për projekte tjera të Agjencisë KIESA.

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet në vitin paraprak/2015	Buxheti për vitin 2016	KASH për vitin ardhshëm
Buxheti i MTI (KIESA):	2,208,263.96	2,200,909.00	2,040,909.00
-Paga dhe mëditje	116,065.45	134,597.00	134,597.00
-mallra dhe shërbime	340,306.16	506,312.00	506,312.00
-shpenzime kapitale	645,356.94	510,000.00	350,000.00
-subvencione dhe transfere	1,106,353.41	1,050,000.00	1,050,000.00
Buxhetet tjera	///	///	0.00
Financimi nga donatorët	///	///	0.00
Shpenzimet e drejtpërdrejta nga MF	///	///	0.00
Gjithsej	2.208.263.96	2.200.909.00	2.040.909.00

Shpenzimet e Institucionet tjera për zona ekonomike

Është investuar edhe nga ana e komunave në të cilat janë krijuar zonat ekonomike, ndër to kanë investuar komunat:

- Shtime në dy vitet e fundit ka investuar vlera prej rreth 40,000 euro.
- Istogu rreth 6,000.00 euro,
- Suhareka rreth 9,000.00 euro,
- Mitrovica rreth 40,000.00 euro

Përvoja nga vendet tjera

Ligji duhet të vendoset në një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore për zonat ekonomike, në përputhshmëri me normat dhe direktivat sipas konventave ndërkombëtare si dhe me praktikatat dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe vendeve anëtare të saj. Propozimi është bërë, duke u bazuar në hulumtimet e bëra nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë. Nga praktikatat e vendeve të tjera është parë në afërsi ndikimi i këtyre zonave në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Ligji rregullon fushëveprimtarinë për zonat ekonomike, i cili përmes dispozitave ligjore dhe përmes akteve tjera që do të nxirren nga ky ligj, synohet të rregullohet mbikëqyrja dhe menaxhimi sa më i mirë në këtë fushë.

Në vazhdim do t'i paraqesim disa modele të zonave ekonomike nëpër botë, ku për Kosovën më të përshtatshme do të ishin përvoja e Turqisë dhe e Maqedonisë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Parku për Hulumtim "Cummings" është ndërmarrje publike. Është model udhëheqës për transformimin e hulumtimeve që biznesi të jetë i suksesshëm. Me një bashkim të 500 kompanive lokale dhe ndërkombëtare të teknologjisë së lartë. Ky park ka për qëllim:

- Të ndjekë rritjen e bizneseve
- Të promovojë përparësitë ekonomike
- Të mbrojë programet federale
- Të rrisë aktivitetet e anëtarëve

Zonat ekonomike në Austri

TECH-GATE, Vienna AUSTRIA, është e rregulluar me Ligjin mbi ndërmarrjet dhe si fushëveprimtari të veten ka:

- Zhvillim dhe hulumtim, shkencë dhe biznes, kompani të reja dhe ato me përmasa globale.
- Telekomunikimi
- Teknologjia informative dhe zhvillimi i "softverëve"
- Bio-teknologjia dhe shkencat natyrore
- Nano-teknologjia dhe teknologjia e sensorëve
- Teknologjia e materialeve

Polonia

Zona Ekonomike Speciale (ZES) në Poloni, janë një kombinim i suksesshëm i nevojave të investitorëve dhe të nevojave të rajoneve të veçanta në të cilat ato janë krijuar. Çdo rajon është një njësi administrative e veçantë e territorit polak, të destinuara për përfortimin e punëve ekonomike në kushte të caktuara. Ndërmarrësit (kompanitë) në ZES kanë të siguruar lehtësim të taksave dhe një përfitim shtesë është fakti se kompania mund të fillojë të veprojë (varësisht nga lloji i biznesit) në një terren të përgatitur posaçërisht për veprimtarinë e kompanisë.

Zonat industriale në Bullgari

Zhvillimi i zonave industriale është një faktor i rëndësishëm për tërheqjen e ndërmarrjeve të reja të prodhimit. Shteti bullgar është duke stimuluar investimet në “ Greenfield-Fusha të Gjelbra” për tërheqjen e investitorëve të rinj përmes një sistemi të stimujve të bazuar kryesisht në aktin e nxitjes së investimeve.

Një nga shembujt më të mirë të suksesshëm të partneritetit publik-privat është Zona Industriale në Rakovski, e cila është e vendosur afër qytetit të Plovdivit.

Kroacia

Në Kroaci zonat ekonomike karakterizohen me *zona të lira ekonomike* që janë të vendosura pranë porteve të mëdha të Kroacisë, si Porti i Pulasit, Porti i Rijekës, Porti i Splitit, Porti i Dalmacisë, Zagrebit etj. Po të analizosh ecurinë e këtyre zonave të ndryshme, vërehet se zhvillimi i tyre është i ndryshëm në lokalitete të ndryshme. Në vija të përgjithshme, zonat e tilla kanë për qëllim tërheqjen e investimeve, veçanërisht të HDI-ve, si qendra tregtie ndërkombëtare për ata operatorë që i përdorin këto zona vetëm për pak kohë. Gjithashtu, shumë kompani janë zhvendosur nga jashtë zonave në brenda tyre.

Shqipëria

Në Shqipëri, historiku i zonave ekonomike fillon me përpjekjet për hartimin e kuadrit përkatës ligjor. Iniciativa për zhvillimin e zonave ekonomike gjen shprehjen e saj procedurale në Ligjin për Zonat Ekonomike dhe konceptin e saj juridik në Ligjin e Koncesioneve. Kuadri ligjor bazë, Ligji i Koncesioneve si dhe Ligji për Zonat Ekonomike inkorporon praktikën më të mirë procedurale në zhvillimin e kësaj iniciative, duke qenë plotësisht konform legjislacionit evropian.

Turqia

Turqia është një shembull shumë i mirë i nxitjes së investimeve të huaja direkte dhe zhvillimit ekonomik të vendit, nëpërmjet krijimit të zonave ekonomike. Si fillim, autoritetet lokale përcaktuan pronësinë e tokës në zonën e paracaktuar dhe shpronësuan tokën private, duke e blerë atë me çmimin e tregut. Pasi përfundoi shpronësimi i tokës, autoriteti lokal filloi me ndërtimin e infrastrukturës bazë dhe zhvillimin e zonave ekonomike, përfshirë edhe zonat e lira ekonomike.

Maqedonia

Disa vlerësime rreth zonave të lira ekonomike në Republikën e Maqedonisë. Shumë analistë të ekonomisë e vlerësojnë si hap të gabuar të qeverisë promovimin e zonave të lira ekonomike, të cilat edhe pas funksionimit disa vjetësh nuk arritën të sigurojnë prezencën e investimit të kompanive të huaja. Zonat ekonomike të krijuara si të tilla ishin pa një koncept dhe strategji. Në një vend kaq të vogël, me një ekonomi të hapur siç është Maqedonia, zonat ekonomike nuk kanë ndonjë rol në konceptin e zhvillimit ekonomik. Mirëpo, vlen të ceket se disa zona kanë lirime nga politikat fiskale deri në 10 vjet.

KAPITULLI 3. SYNIMET DHE OBJEKTIVAT

Synimet e këtij koncepti dokumenti të propozuar është krijimi i një ambienti me të mirë të bërit biznes, me fokus kryesor në krijimin e kushteve më të përshtatshme për tërheqjen e investimeve të huaja dhe rritjen e punësimit.

Objektivat: ngritja dhe mbështetja në zhvillimin e sektorit privat si dhe përmirësimi i kornizës ligjore të zonave ekonomike, i cili ka për qëllim të harmonizojë legjislacionin në mënyrë që të jetë sa më i zbatueshëm.

Disa nga veprimet janë:

- Eliminimi i kolezionit të kompetencave të nivelit qendror dhe atij lokal sa i përket krijimit të zonave ekonomike.
- Eliminimi i procedurave burokratike (marrjen e pëlqimeve nga institucionet qeveritare për procedimin e lëndës për krijimin e zonës ekonomike, dhënien e parcelave për shfrytëzim nga ana e bizneseve)
- Ofrimin e lehtësirave për bizneset që vendosen në zonat ekonomike,
- Forcimi i mbikëqyrjes së operimit të zonave ekonomike.

KAPITULLI 4: OPSIONET

Opsioni 1: Opsioni i status-quo (pa ndryshim)

Mos ndryshimi i politikave legjislative aktuale të zonave ekonomike për të tërhequr investime apo vazhdimi i gjendjes aktuale të këtij legjislacioni, do të nënkuptonte vazhdimin e gjendjes aktuale, hezitimin e investitorëve, e sidomos të huajve për të investuar në Kosovë, pasi që definimi i pronës dhe infrastruktura fizike është njëra ndër kërkesat e para dhe kryesore për një investitor.

Mangësitë: Lënia e gjendjes aktuale të pandryshuar do të thotë që vendet fqinje me të cilat Republika e Kosovës është në garë të drejtpërdrejtë për investime private, do të vazhdojnë të kenë legjislacion më të përshtatshëm për tërheqjen dhe nxitjen e investimeve, si atyre vendore poashtu edhe të jashtme. Rrjedhimisht, si rezultat i këtyre pengesave, investitorët e jashtëm do të vazhdojnë ta anashkalojnë Kosovën, ndërkaq kapitalin e tyre financiar do ta derdhin në vendet fqinje.

Opsioni 2: Plotësim ndryshimi i Ligjit për zonat ekonomike dhe akteve nënligjore

Ky objektivi ka të bëjë me plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit për zona ekonomike, me qëllim të krijimit të një mjedisi, ku ndërmarrësit kanë lehtësira për t'u zhvilluar dhe do të jenë më konkurrentë në tregjet e rajonit dhe me gjerë. Legjislacioni i zonave ekonomike do të plotësohet brenda afateve të parapara dhe të jetë sa më fleksibil, njëkohësisht edhe i qartësuar me kushtet dhe kriteret për krijimin e zonave ekonomike.

Ndryshimet që planifikojmë të bëjmë në ligjin aktual të zonave ekonomike, janë të paraqitura në vijim, ku në mënyrë më të zgjeruar janë paraqitur edhe me lartë tel “Ligjet dhe aktet nenligjore”.

- Neni 5 – për konfuzionin e krijuar ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror në lidhje me të drejtat e krijimit të zonave ekonomike,
- Neni 6 – për mos definimin konkret të emërimit “zonë e lirë” ekonomike, pasi që të qenit në zonë të lirë ekonomike nuk paraqet asnjë benifit përveç atyre që janë të paraqitura në kodin doganor dhe të akcizave.
- Neni 8 dhe 9 – duhet të sigurohet që plani kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike nuk duhet të bie ndesh me ligjin për zona ekonomike.
- Neni 16 – Librat e kontabilitetit dhe raportimi, të fshihet, pasi që është rregulluar me legjislacion përkatës dhe nga institucionet përkatëse.
- Neni 18 – të parashihen afatet kohore për fillimin e aktivitetet në zonën ekonomike, që nga krijimi i zonës.
- Neni 20 Këshilli Kombëtar për zona ekonomike. Të fshihet
- Neni 21 Dispozitat ndëshkuese, tek paragrafi 1, pika 1.1
1. Personi juridik ose subjekti do t’i nënshtrohet një gjobë prej dymijë (2.000) euro deri dhjetë mijë (10.000) euro, nëse ai kryen një nga shkeljet në vijim:

- o 1.1. fillon veprimtarinë në zonën ekonomike para marrjes se miratimit të nevojshëm të autoriteteve përkatëse.

Pika 1.1 e paragrafit 1 të nenin 21 të fshihet.

Poashtu do të bëhen lehtësira në procedurat për marrjen e pëlqimit për krijimin e zonës ekonomike, të cilat janë të parapara në UA 01/2014, pasi që në bazë të këtij UA momentalisht kërkohen këto dokumente për të krijuar një zonë ekonomike:

- Kërkesa drejtuar MTI-së
- Në rast se iniciuesi është institucion publik duhet t’ia bashkagjet vendimin, ndërsa kur inicuesi është subjekt tjetër juridik duhet të bashkangjet statutin;
- Arsyeshmëria (Studimi i fizibilitetit) për krijimin e ZE;
- Dëshmi mbi pronësinë apo posedimin/kontratën e shfrytëzimit
- Plani rregullues urban komunal;
- Pëlqimin nga institucionet përgjegjëse:
 - o Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural;
 - o Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
 - o Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale;
 - o Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
 - o Ministria e Infrastrukturës;
 - o Komuna përgjegjëse;
- Dëshminë që ka zhvilluar konsultimet me publikun.
- Projekti ideor i ZE-s
- Plani investues
- Kohëzgjatja e operimit të Zonës;

- Projekt për trajtimin e ujërave të zeza;
- Projekt për furnizim me ujë;
- Projekt për furnizim me energji elektrike - zgjidhje teknike;

Për të qenë konkurrent me vendet tjera, poashtu rekomandojmë që të ketë lehtësira në tatime dhe taksa për 10 vitet e para për bizneset që vendosen në zona ekonomike, pasi që një gjë e tillë praktikohen edhe në disa zona ekonomike në Maqedoni, andaj më qëllim që të jemi konkurrent më këtë shtet fqinjë për tërheqjen e investimeve të huaja, atëherë i rekomandojmë këto lehtësira.

Zonat ekonomike rekomandohet që të jenë të ndara për disa sektorë, për shembull kemi raste kur brenda një zonë ka prodhues farmaceutike dhe riciklues mbeturinash, apo mund të ketë prodhues të ushqimeve më ndonjë sektor tjetër.

Për më gjerësisht nenet ku planifikohen të ndryshohet ligji aktual mund të i shihni tek pjesa e mësipërme **“Ligjet dhe aktet nënligjore”**

KAPITULLI 5: PËRMBLEDHJA E OPSIONEVE

	Opsioni 1	Opsioni 2
Karakteristikat kryesore të opsionit	Gjendja aktuale ligjore nëse mbetet e pandryshuar, investitorët e huaj dhe vendor mund të investojnë në vendet fqinjë për shkak të procedurave burokratike dhe mos ofrimit të lehtësirave në zona ekonomike në Kosovë.	Ligji për zonat ekonomike të ndryshohet dhe plotësohet sipas nevojave të paraqitura për zhvillim sa më të mirë të zonave ekonomike, si tek eliminimi i procedurave byrokratike për krijimin e zonave ekonomike, format e menaxhimit, krijimin e lehtësirave për biznese, etj. Me gjerësisht mund t'i gjeni në pjesët e mësipërme të këtij koncept dokumenti.
Popullsia e synuar / sektorët / <u>rajonet e ndikuara</u>	Janë ndërtuar zonat ekonomike në rajonin e: Prishtinës (Drenas), Mitrovicës, Prizrenit (Suharekë) dhe Ferizajt (Shtime)	Zgjerimi i zonave ekonomike edhe në rajone tjera të Kosovës pra përveç rajonit të: Prishtinës (Drenas), Mitrovicës, Prizrenit dhe Ferizajt (Shtime), planifikojmë të zgjerohemi edhe në rajonin e Pejës, Gjilanit dhe Gjakovës.

Karakteristikat e zbatimit - Kush është përgjegjës: qeveria (kush), sektori privat, qytetarët	MTI-ja, komunat përkatëse ku janë të krijuara zonat, asociacioni i biznesit dhe vet bizneset.	MTI-ja, komunat përkatëse ku janë të krijuara zonat, asociacioni i biznesit dhe vet bizneset.
Administrimi ose ofrimi i programit apo shërbimit	Njësitë në kuadër të MTI-së dhe të komunave përkatëse, ku janë të krijuara zonat ekonomike	Njësitë në kuadër të MTI-së, konkretisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), si dhe Departamenti i Industrisë, ndërsa komunat përkatëse për nivelet komunale varësisht së në kuadër të cilës komunë është krijuar zona ekonomike.
Legjislacioni primar, legjislacioni sekondar, amendamentimet, zbatimi, dënimet	Ligji nr. 04-L159 U.A. nr. 01/2014(MTI) U.A. nr. 02/2014(MTI) U.A. nr. 03/2014(MTI) U.A. nr. 17/2013(MTI) U.A. nr.03/2014(QRK)	Plotësim-ndryshimi i Ligjit nr. 04-L159 dhe i akteve nënligjore në vijim: U.A. nr. 01/2014(MTI) U.A. nr. 02/2014(MTI) U.A. nr. 03/2014(MTI) U.A. nr. 17/2013(MTI) U.A. nr.03/2014(QRK)
Fushatë ndërgjegjësimi dhe informimi	Aktualisht, nuk është paraparë asnjë aktivitet	Fushatë promovimi dhe informimi përmes takimeve, konferencave, debateve, broshurave, etj
Udhëzimet dhe kodet	N/A	
Afatet kohore - kur do të hyjë në fuqi opsioni	N/A	Fundi i vitit 2016 për ligjin, derisa pjesa e parë e vitit 2017 për UA.

KAPITULLI 6: ANALIZA E OPSIONEVE

Përparësitë:

Opsioni 1: Nuk ka ndonjë përfitim më të madh të parashikueshëm sesa zhvillimi aktual i zonave ekonomike. Mosveprimi do të ndikojë në humbjen e mundësive të shumta për tërheqjen e investimeve, e si rrjedhojë do të ndikojë në humbjen e qindra miliona eurove, të cilat mund t'i përfitojë ekonomia e Kosovës, përmes tërheqjes së investimeve private.

Opsioni 2: Projektligji i ri, i plotësuar dhe ndryshuar do të përcaktojë procedurat më të thjeshta të krijimit të zonave ekonomike, si dhe të zhvillimit të tyre, si dhe elemente favorizuese, lehtësuese dhe përshpejtuese për bartjen e së drejtës së shfrytëzimit të pronës nga investitorët e mundshëm, në funksion të arritjes së qëllimit kryesor për tërheqjen e investimeve private. Vlerësohet që rritja e investimeve private do të ndikojë në rritjen dhe qarkullimin financiar në ekonominë e Kosovës. Pjesa më e madhe e këtij qarkullimi do të vijë nga rritja e prodhimitarisë vendore, eksporteve dhe krijimit të vendeve të reja të punës, të cilat do të ndikojnë në rritjen e të hyrave buxhetore dhe përmirësimin e bilancit tregtar të ekonomisë së Kosovës.

Kostoja:

Për realizimin e këtij qëllimi në vitet 2016 dhe 2017, nuk ka ndonjë ndikim financiar shtesë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, realisht nuk tejkalohen limitet buxhetore, kurse për vitet 2018, e tutje planifikojmë të zgjerojmë zonat ekonomike, por ato janë kërkesa për investime kapitale, jo implikime buxhetore të ligjit. Ato janë paraqitur edhe me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (2017-2019).

Tërheqja e investimeve private, si të atyre vendore ashtu edhe të huaja në Kosovë, do të ketë ndikim të madh në rritjen e të hyrave buxhetore dhe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës, në një afat më të gjatë kohor. Është e nevojshme që Ligji për Zonat Ekonomike (ndryshim-plotësimi) të miratohet këtë vit, ashtu që Kosova të fillojë sa më shpejt të përfitojë nga investimet private, gjë që kërkon që ligji të hartohet dhe të shpallet sa më shpejt që është e mundur.

KAPITULLI 7: KONSULTIMET

Ministria e Tregtisë edhe Industrisë gjatë hartimit të koncept dokumenti është konsultuar me prodhuesit shoqatat e bizneseve që janë në parkun në Drenas, janë vizituar bizneset në zonën ekonomike në Shtime dhe Mitrovicë, të cilat kanë përkrahur propozimin Nr. 2 të këtij koncept dokumenti për plotësimin edhe ndryshimin e ligjit për zonat ekonomike. Po ashtu MTI është konsultuar edhe me komunat e Kosovës, respektivisht komunat që kanë të krijuar zonat ekonomike të cilat kanë kërkuar dhe rekomanduar që të eliminohen disa nga procedurat (dokumentet) për krijimin e zonës ekonomike, po ashtu është konsultuar MAPL e cila po ashtu ka përkrahur iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin për ligjin për zonat ekonomike. MKRS kërkon që gjatë ndërtimit të zonës ekonomike, në rast që haset në ndonjë element të dyshimtë të trashëgimisë kulturore të njoftohen autoritetet përkatëse.

Konsultimet te mëtutjeshme paraprake dhe publike janë organizuar në përputhje me Rregulloren 09 2011 e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku janë përfshira të gjitha

institucionet e parapara me nenin 7 të rregulloren së punës së qeverisë dhe odat ekonomike dhe grupet e interesit të parapara me nenin 32 të rregullores së punës së Qeverisë.

KAPITULLI 8: KRAHASIMI I OPSIONEVE

Nga të dy opsionet e identifikuar:

Opsioni 1 – Nuk rekomandohet pasi që mund të merret parasysh se në rast të mosveprimit, do të rezultojë në humbjen e investimeve në Kosovë, humbjen e vendeve të reja të punës, prodhimit vendor dhe rritjes së eksporteve, si dhe të shumë faktorëve tjerë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Opsioni 2 – Është opsion i preferuar, sepse aprovimi i ligjit të ri me ndryshim-plotësime do të ndikojë direkt në rritjen e investimeve dhe të punësimit në Kosovë. Po ashtu, do të ndikojë edhe në rritjen e eksporteve, prodhimit vendor dhe përfundimisht do të ndikojë në rritjen e konkurrencës dhe efikasitetit të ekonomisë së Kosovës.

KAPITULLI 9: REKOMANDIMET

Pas shqyrtimit të dy opsioneve për zgjidhjen e kësaj çështjeje, ne rekomandojmë që Qeveria të miratojë këtë koncept-dokument dhe të zgjedhë opsionin e dytë (plotësim-ndryshimin e ligjit të zonave ekonomike) si opsioni më i favorshëm për të arritur synimet e përshkruara me këtë koncept-dokument.

Me qëllim të eliminimit të pengesave në tërheqjen dhe realizimin e investimeve të huaja në Kosovë, është e nevojshme të përshpejtohet procesi i plotësim-ndryshimit të Ligjit për Zonat Ekonomike.

Plotësim-ndryshimi i Ligjit për Zonat Ekonomike do të jetë shumë i dobishëm për ekonominë e Kosovës, pasi që do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e bizneseve, uljen e papunësisë si dhe rritjen e të hyrave buxhetore. Bizneset do të përfitojnë infrastrukturën fizike, përqendrimin e bizneseve në një vend të caktuar dhe promovimin e tyre, zgjerimin e bashkëpunimit mes bizneseve, krijimin e kushteve për biznese për qasje më të lehtë në transport, furnizim me energji, ujë dhe shërbime në mbështetje të biznesit. Kosova, përfundimisht do të përfitojë nga rritja e prodhimit, përmirësimin e bilancit tregtar, rritjes së punësimit, rritjes së tatimeve në të ardhura të korporatave etj.

KAPITULLI 10: KOMUNIKIMI

Komunikimet do të jenë të ndryshme, duke filluar nga takimet, grupet punuese dhe publikimet në Ubfaqen (faqen e internetit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, komunikimi do të jetë aktiv, i drejtpërdrejtë dhe konstruktiv. Të gjithë autorët duhet të konsultohen mbi tekstin në draft para se të dërgohet në Kuvend dhe të merren parasysh komentet, kur janë të duhura. Pasi që ligji të hyjë në fuqi, fillon fushata vetëdijesiveve e sugjeruar në këtë dokument, dhe sugjerohet që kjo të vazhdojë për një kohë. Kjo do të kombinohet me veprimet e vazhdueshme të trajnimit dhe asistencës së ndërmarrësve.

Gjithashtu, tre muaj para se ligji të hyjë në fuqi, duhet të identifikohen kompanitë –ndërmarrjet dhe të ofrohet ndihmë dhe trajnim për t'i lejuar ata që të përgatiten.